




### Deklaratat e analizuara:

**15 Deklarata të analizuara**

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri Periodik/Vjetor 2017)

## Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2017




Pasuria para fillimit të detyrës është 0;  
Pasuria bruto me datë 31.12.2019 është  
54,347,623 lekë

+ 3,881,973 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë


## Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë


### Likuiditete në Bankë




### Likuiditete në Cash



### Pasuritë e Luajtshme



### Pasuritë e Paluajtshme



## Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2004-2017	Shuma në Lekë	Raporti në %
Paga nga funksioni	13,931,295	38.6%
Të ardhura nga aktiviteti i bashkëshortit	10,750,162	29.8%
Të ardhura nga Qira	1,860,000	5.1%
Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme	7,413,514	20.5%
Të ardhura të tjera	2,173,249	6.0%
<b>Total</b>	<b>36,128,220</b>	<b>100%</b>



## Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

**3 Me Probleme**  
**11 Pa Probleme**

Subjekti Anila Galanxhi rezulton me burime të pamjaftueshme financiare në tre vite të deklarimit të pasurisë, konkretisht në vitin 2004 në shumën 915,736 lekë, në vitin 2009 në shumën 10,836.114 lekë dhe në vitin 2015 në shumën 1,669,989 lekë.

Në vitin 2004 deklarohet që bashkëshorti i subjektit ka marrë si dhuratë nga vëllai i tij, emigrant në Gjermani, një autoveturë tip Benz me vlerë 700,000 lekë.

Në vitin 2005 është shtuar një depozitë bankare prej 49,500 eurosh e deklaruar në pronësi të vëllait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, e cila nuk është përfshirë në këtë analizë dhe nuk reflektohet as në grafiqet e mësipërm.

Në deklarimin e vitit 2006 subjekti paguan këstin e parë prej 31,300 euro për një kontratë sipërmarrje për blerje apartamenti me sipërfaqe 100 m<sup>2</sup> dhe garazh 30 m<sup>2</sup> [vlera totale 100,000 euro] dhe si burim deklaroun edhe 640,000 lekë nga shitja e shtëpisë së prindërve, por bashkëpronësia nuk është deklaruar më parë.

Në vitin 2007 deklarohet huamarrje te një person fizik në shumën 20,000 euro pa interes, që shlyhet në vitet në vijim si dhe një detyrim 1,400 euro ndaj vëllait për makinën e sjellë nga Gjermania. Gjithashtu në vitin 2007, deklarohet investimi në ndërtimin e një pallati 8-katësh në Vlorë, ku bashkëshorti i subjektit ka investuar 10 mijë euro, ndërsa vëllai i tij emigrant, 90 mijë euro –me pjesë takuese nga 50% secili.

Në vitin 2009, bashkëshorti i subjektit deklaroun se është "poseudes i një shtëpie në 1/3 pjesë e përfutur nga kontrata e privatizimit në vitin 1991, e regjistruar në vitin 2009 me sip. 55 m<sup>2</sup>, të cilën po e rikonstrukton për ta kthyer në mjedis tregtar" me vlerë 82,000 euro. Kjo pronë nuk rezulton e deklaruar më parë dhe nuk është e qartë nëse vlera prej 82,000 euro përfaqëson vlerën e tregut apo të rivlerësimit.